

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-09-0098

Në padinë e

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]
3. [REDACTED]
4. [REDACTED]
5. [REDACTED]
6. [REDACTED]
7. [REDACTED]
8. [REDACTED]
9. [REDACTED]
10. [REDACTED]
11. [REDACTED]
12. [REDACTED]
13. [REDACTED]

Paditësit

kundër

Agjencia Kosovare e Privatizimit

E Paditura

[REDACTED]

Ankuesi

Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Kolegji i Ankesave i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 09 mars 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 05 nëntor 2009, Trupi Gjykues e lëshoi një aktvendim me anën e të cilit e zgjati afatin kohor në lëndën SCEL-09-0025, sipas përshkrimit të nenit 67.12 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6 edhe për një periudhë prej 90 ditëve nga 11 nëntori 2009, duke e bazuar këtë aktvendim në nenin 21.1 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6.

Aktvendimi iu dërgua Ankuesit më 18 nëntor 2009. Më 01 dhjetor 2009, Ankuesi e ushtroi ankesën e tij në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së. Ai pohoi se vendimi i marrë nuk është në përputhje me ligjin.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa, megjithëse brenda afatit është e papranueshme.

Ankesa mund të jetë e pranueshme nëse ka bazë ligjore dhe faktike për Ankuesin, e cila del nga aktvendimi i kontestuar. Këtu kemi të bëjmë vetëm me faktin, nëse aktvendimi i kontestuar ka ndonjë efekt ligjor. Aktvendimi i Trupit Gjykues i DHPGJS-së i datës 05 nëntor 2009 nuk e përmban këtë efekt ligjor.

Neni 67.12 i UA-së të UNMIK-ut 2008/6 thotë se aktvendimi (final) i Trupit Gjykues në të ashtuquajturën Lëndë me Lista të Punëtorëve do t'i dërgohet ankuesit(ve) dhe Agjencia në çdo rast jo më vonë se 90 ditë nga data në të cilën ankesa u parashtrua në Regjistër. Dispozita e cituar nuk e parasheh ndonjë pasojë nëse Trupi Gjykues nuk i përbahet asaj. Neni 67.12 i UA-së të UNMIK-ut 2008/6, prandaj, është lex imperfecta, dispozita ligjore nga e cila në rast të prishjes së saj nuk prodhon ndonjë efekt ligjor. Me falë të tjera, është vetëm një dispozitë e cila konstaton një rezultat të dëshirueshëm por jo obligues, - në bazë të gjendjes faktike të DHPGJS-së në lidhje me stafin dhe ngarkesën e punës-trajtimi më i shpejtë i mundshëm të Lëndëve të Listave me Punëtorë brenda shkallës së parë.

III

Neni 67.12 i UA-së të UNMIK-ut 2008/6, madje nuk e përshkruan periudhën kohore në kuptim të nenit 21.1 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6, pasi që pika e dytë e kësaj dispozite qartëson se periudhat kohore të përshkruara me ligj në kuptim të kësaj norme janë vetëm periudhat kohore për palët, por jo të atilla që i jepen gjykatës.

Duke e marrë parasysh se aktvendimi i kontestuar i Trupit Gjykues nuk ka substancë ligjore e cila do të kishte efekt ligjor apo faktik për Ankuesin. Nga përbajtja e tij nuk është asgjë veçse njoftim për palët se gjykata nuk është në pozitë të finalizojë procedurat brenda limit kohor, të cilit – gabimisht – i është dhënë forma e aktvendimit.

Aktvendim për shpenzime nuk do të duhej të lëshohej.

Richard Einkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it _____ (nënshkrimi)

Torsten Frank Koschinka, Gjyqatr i EULEX-it _____ (nënshkrimi)

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it _____ (nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it _____ (nënshkrimi)